

## Veprimtaria normale e sektorit të kujdesit për fëmijë gjatë pandemisë

### Ministri i Familjes Stamp: Më 17 Gusht do të zërë vend - kushtëzuar nga incidenca e infeksionit - rikthimi në veprimtarinë normale

Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritit ju informon:

Nordrhein-Westfalen vazhdon rrugëtimin gradual dhe të përgjegjshëm për sa i përket sektorit të kujdesit ditor për fëmijë. Duke filluar nga data 17 Gusht do të zërë vend nën kushtet e pandemisë rikthimi në veprimtarinë normale në sektorin e kujdesit ditor për fëmijë. Të gjithë fëmijët do të munden - nën konsiderimin e vazhdueshëm të përhapjes së infeksionit, nevojave të fëmijëve, interesave të punonjësve dhe shqetësimeve të familjeve - të rikthehen tek qendrat e kujdesit ditor për fëmijë dhe tek personat të cilët angazhohen me përkujdesjen e fëmijëve në masën e rënë dakord sipas kontratës. Mbi të gjitha kjo tregon për rutinën e përditshme të ambienteve të kujdesit ditor për fëmijë që mund të implementohen sërish konceptet edukative të testuara dhe të provuara.

Ministri i Familjes Joachim Stamp: „ Të punësuarit në sektorin e kujdesit ditor të fëmijëve dhe familjet kanë treguar një forcë të paimagjinueshme në muajt e fundit. Do të doja të falenderoja përzemërsisht të gjithë personat e përfshirë për përkushtimin dhe fleksibilitetin e tyre madhor. Për mua ishte gjithnjë e qartë se duhet të garantohej mbrojtja e të gjithëve, e punonjësve në mjediset e kujdesit ditor për fëmijë, e personave të cilët angazhohen me përkujdesjen ditore të fëmijëve , e prindërve dhe e fëmijëve dhe çdo hap i hapjes duhet të konsiderohej me kujdes. Pas diskutimit me të gjithë personat e përfshirë, ne e konsiderojmë paraqitjen e propozimit të plotë të rregullt si veprim të përgjegjshëm. Ne do të rifillojmë veprimtarinë normale më 17 Gusht - megjithëse kjo mbetet e kushtëzuar nga përhapja e infeksionit. Diçka është e qartë : Kjo mbetet një veprimtari e rregullt gjatë pandemisë."

Parimisht është e qartë: Pavarësisht të gjithave mund të ndodhin kufizime të reja në varësi të incidencës së infeksionit, rekomandimeve të RKI ose gjetjeve të tjera empirike dhe shkencore. Aktualisht nuk mund të përjashtohen as rregulloret kombëtare.

Ky hap i mëtejshëm i hapjes është diskutuar paraprakisht me organet drejtuese dhe përgjegjëse të sektorit të kujdesit për fëmijë dhe me komunat, me sindikatat dhe mjekët pediatër. Gjithashtu janë marrë parasysh rezultatet shkencore si dhe eksperiencat e fituara prej veprimtarisë së kufizuar të rregullt. Në konsultim të ngushtë me organet përgjegjëse dhe drejtuese të qendrave të kujdesit dhe me komunat, ministria ka rënë dakord që mos të fillojë veprimtarinë normale direkt në fund të pushimeve të verës, por ta fillojë atë më 17 Gusht.

Ministri i Familjes Joachim Stamp: „ Qeveria e Republikës ka përmbushur kërkesën e organeve drejtuese dhe përgjegjëse të qendrave të kujdesit ditor për t'u siguruar se të gjitha mjediset, duke përfshirë ato të cilat i kane kohët e mbarimit të pushimeve në gjysmën e dytë të pushimeve shkollore , të kenë mjaftueshëm kohë për kalimin në veprimtarinë normale.

Në sektorin e kujdesit ditor, nuk mund të implementohen masa thelbësore mbrojtëse të cilat vlejné jashtë tij . Nuk është e mundur të mbikëqyret masa e mbajtjes së distancave midis fëmijëve ose midis fëmijëve dhe stafit pedagogjik ose personave të cilët angazhohen me përkujdesjen ndaj fëmijës. Gjithashtu, pajisja me një maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës nuk është e implementueshme tek fëmijët. Si rrjedhim, implementimi i masave të higjienës në sektorin e kujdesit ditor për fëmijë vazhdon të jetë me rëndësi të veçantë. Masat e përgjithshme të mbrojtjes të cilat synojné të parandalojné shpërndarjen e virusit, vazhdojnë të qëndrojnë në fuqi dhe rregullohen veçmas. Kjo ndikon në kërkesën e distancimit midis të rriturve, në pajisjen me maskë e cila mbulon gojën dhe hundën tek të rriturit nëse nuk respektohet distancimi dhe tek sigurimi i gjurmueshmërisë së rasteve të mundshme të infeksionit dhe masat e veçanta të higjienës.

Në mënyrë që të përmbushen standartet e mbrojtjes së shëndetit për punonjësit dhe për të siguruar mungesë rrezikshmërie më të madhe në përballjen me koronavirusin , shteti ka vendosur se të gjithë personat e përfshirë do të testohen menjëherë dhe masivisht nëse ndodh një infeksion tek

vendndodhja e mjedisit të kujdesit ditor për fëmijë. Për më tepër, të gjithë punonjësit në sektorin e kujdesit ditor për fëmijë dhe personat të cilët angazhohen me kujdesin ditor të fëmijëve mund të testohen çdo 14 ditë deri gjatë pushimeve të vjeshtës. Kostot për këtë gjë mbulohen nga shteti. Nëse detektohet një infeksion gjatë këtyre testeve, do të merren masa të mëtejshme prej autoriteteve shëndetësore.

Në mënyrë që të plotësohen kërkesat në rritje për implementimin e standarteve të higjienës ( dezinfektimin, larjen e duarve, përgatitjen e ushqimit, vëzhgimin e distancimit ) , organet drejtuese dhe përgjegjëse të mjediseve të kujdesit ditor për fëmijë do të marrin mbështetje financiare afatshkurtër. Benefitet do të shërbejnë veçanërisht për të financuar stafin shtesë ndihmës në fushën jopedagogjike dhe për të lehtësuar organet drejtuese dhe përgjegjëse të sektorit të kujdesit ditor për fëmijë prej kostove të paparishikueshme dhe në rritje të pajisjeve të higjienës dhe të sigurisë në punë.

Ministri i Familjes Stamp: " Ndhmësit e qendrave të kujdesit për fëmijë e lehtësojnë stafin prej detyrave të thjeshta të përditshme. Ato nuk janë një zëvendësim për stafin pedagogjik , por një mbështetje në rutinën e përditshme të qendrave për kujdesin e fëmijës. Kujdesi pedagogjik dhe edukimi i fëmijërisë së hershme mundësohet nga stafi jonë i kualifikuar. Si fillim, programi i republikës tonë është planifikuar të vazhdojë deri në fund të vitit. "

### **Kërkesa ligjore për veprimtarinë normale duke filluar nga data 17 Gusht:**

Rregulloret ligjore të Kodit të Tetë Social ( SGB VIII ) dhe të Ligjit për Edukimin e Fëmijëve ( KiBiz ) janë të vlefshme pa kufizime.

- Masat mbrojtëse të përgjithshme për të parandaluar përhapjen e SARS-CoV-2 janë ende të vlefshme dhe janë të rregulluara veçmasi.
- Për vendosjen e stafit në mjedise të kujdesit ditor për fëmijë ,është e vlefshme rregullorja e re e stafit e cila është në fazat e fundit të koordinimit. Ajo do të publikohet sa më shpejt të jetë e mundur në Gusht. Vlerësimi i rrezikut individual i cili duhet të kryhet si pjesë e vlerësimit të rrezikut të shëndetit në punë mund të çojë në burime të reduktuara të personelit në punën pedagogjike ditore të sektorit të kujdesit për fëmijë. Në mënyrë që të merret në konsideratë kjo situatë e veçantë, rregullorja e stafit mundëson një hapje të përkohshme ose mundësinë e shmangies nga standartet ekzistente.

### **Kjo do të thotë për implementimin se:**

- Nuk do të vlejë më pas datës 17 Gusht 2020 "Manuali për një veprimtari të rregullt të kufizuar në sektorin e kujdesit ndaj fëmijëve sipas kërkesave për mbrojtjen nga infeksioni prej pandemisë së SARS-CoV-2 " .
- Duhet të përmbushen kërkesat për lejimin e veprimtarisë.
- Mund të implementohen sërish konceptet pedagogjike të planifikuara për veprimtarinë normale.
- Fëmijët do të jenë përsëri nën përkujdesjen e rënë dakord sipas kontratës.
- Nëse nuk mund të përmbushet standarti minimal i stafit në një mjedis të kujdesit ditor për fëmijë, kjo rrethanë e cila ndryshon nga veprimtaria normale duhet të raportohet nga organi përgjegjës dhe drejtues i sektorit të kujdesit ditor për fëmijë tek zyra përkatëse për mirëqenien e të rinjve në përputhje me § 47 SGB VIII, dhe duhet të krijohet zgjidhje për mirëmbajtjen më të mirë të mundshme të veprimtarisë ditore. Në të kundërt, kjo gjë mund të çojë në kufizime në kujdesin e vendosur në dispozicion.
- Të gjithë të rriturit duhet të ruajnë një distancë minimale prej 1.5 metrash midis njëri tjetrit. Kjo vlen për rastet midis punonjësve në mjedise të kujdesit për fëmijë dhe personave të cilët angazhohen me përkujdesjen e fëmijëve , midis të punësuarve ose personave të cilët angazhohen me përkujdesjen e fëmijëve dhe prindërve dhe punonjësve në mjedise të kujdesit për fëmijë ose personave të cilët angazhohen me përkujdesjen e fëmijëve dhe personave të jashtëm.
- Në rastet kur kemi të bëjmë me të rritur të tjerë, duhet të vendoset gjithnjë një maskë e cila mbulon gojën dhe hundën nëse nuk respektohet distanca prej 1.5 metrash.
- Duhet të vazhdojë të garantohet gjurmimi i rasteve të mundshme të infeksionit .
- Duhet të vazhdojnë të implementohen masat e nevojshme të higjienës .

Mund të gjeni këtu informacione dhe rekomandime të mëtejshme.

**Na ndiqni në internet:**

Twitter: @chancenrw

Facebook: Chancen NRW

Instagram: Chancen\_nrw

YouTube: Chancen NRW

***Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritit, Telefon 0211 837-2417.***

***Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës [www.land.nrw](http://www.land.nrw)***

**[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)**